



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 26
Prishtinë, më 20.6.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Fitore Pacolli, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Evgjani Thaçi-Dragusha, Sërgjan Mitroviq dhe Zafir Berisha.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Doruntinë Maloku-Kastrati.

Pjesëmarrës nga Qeveria: Enver Hoxhaj, zëvendëskryeministër me bashkëpunëtorët: Almira Sylaj e Besart Lumi.

Pjesëmarrësit e tjerë: Butrint Berisha, PIPS, Rita Nushi e Albert Krasniqi, KDI, praktikantë dhe media.

Nga zyra e komisionit: Minire Hasani e Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 18 maj dhe 1 qershor 2018;**
- 3. Takim i komisionit me zëvendëskryeministrin, z. Enver Hoxhaj;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratim i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 18 maj dhe 1 qershor 2018

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet të mbledhjeve të mbajtura më 18 maj dhe 1 qershor 2018.

3. Takim i komisionit me zëvendëskryeministrin, z. Enver Hoxhaj

Vjosa Osmani-Sadriu e falënderoi zëvendëskryeministrin Hoxhaj për përgjigje pozitive në ftesën e komisionit. Ajo ia kaloi fjalën zëvendëskryeministrit që të njoftojë anëtarët e komisionit lidhur me marrëveshjet bilaterale me Shqipërinë, për aq sa është në kompetencë të tij, për marrëveshjet me Maqedoninë dhe për çështje të tjera për bashkëpunimin rajonal. Ajo njëkohësisht falënderoi zëvendëskryeministrin për raportin me shkrim për anëtarët e komisionit.

Enver Hoxhaj njoftoi se në raport me pikat e propozuara për diskutim, mbulon mbi të gjitha Maqedoninë, por se mund të flasë edhe për marrëveshjet me Shqipërinë, për të cilat theksoi se zëvendëskryeministri Limaj i mbulon ato dhe ai është i gatshëm që të njoftojë. Tani Maqedonia tha se e ka zgjidhur kontestin e vjetër për çështjen e emrit që ka një peshë për Kosovën edhe për rajonin, e që ishte një ndër sfidat e rajonit. Z. Hoxhaj njoftoi se në muajin shkurt është takuar me krerët institucional të Maqedonisë në Shkup, ku është biseduar për tema të marrëveshjeve të cilat do të duhej të trajtoheshin në mbledhjen e qeverive të të dy vendeve. Ai njoftoi për vendosjen e gurthemelit për vendosjen e pikës së përbashkët kufitare në Stançiq dhe Bellanovc, e cila do të jetë në dispozicion për njerëz dhe mallra. Kjo pikë e përbashkët kufitare ka edhe një vlerë të veçantë sepse do të shkurtojë rrugën e transportit prej Bullgarisë e Turqisë që pos që do të jetë integrim i menaxhuar i kufirit, mund të vlerësohet prej pikave kufitare më të mira që mund të ketë rajoni. Po ashtu njoftoi edhe për interesimin e hapjes së pikës kufitare në Han të Elezit, si dhe në Gllloboqicë. Temë tjetër e bisedimeve tha se është rregullimi i dokumentacionit të banorëve në brezin kufitar të të dy vendeve. Në bisedime është zbritja e çmimit të roamingut, si dhe çështja e finalizimit të autostradës Arbër Xhaferi. Z. Hoxhaj njoftoi edhe për partneritetin strategjik me Shqipërinë me ç' rast ftoj anëtarët e komisionit që të ndihmojnë për atë se çfarë duhet të shtohet në atë deklaratë. Ai më pas përmendi të gjitha marrëveshjet në mes të Kosovës e Maqedonisë, të cilat do të nënshkruhen në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive.

Zafir Berisha, lidhur me deklaratën e zëvendëskryeministrit të dhënë më 28 prill për ulëse të Kosovës në OKB, e pyeti atë se çka nënkupton kjo deklaratë, se a është ndonjë paralajmërim për kompromise të reja të mundshme. Ai po ashtu pyeti se cila është arsyeja që Qeveria e ka tërhequr platformën shtetërore për bisedime me Serbinë dhe se a është tërhequr me qëllim që presidenti Thaçi të shkojë në bisedime me Vuçiqin, se a ka qenë e koordinuar kjo në mënyrë që Kuvendit t'i hiqet mundësia që të kërkojë unitet politik në këto bisedime.

Fitore Pacolli-Dalipi, për marrëveshjet të cilat Kosova do të nënshkruhen me Maqedoninë pyeti, se: në cilën pikë dhe linjë Kosova ka planifikuar të bashkëpunojë me Maqedoninë në Marrëveshjen për energjinë; çfarë përmban lehtësimi i qarkullimit për banorët e zonave kufitare dhe cilat janë afatet; çka përmban marrëveshja në fushën e drejtësisë, a është diskutuar rasti Kumanova dhe raste të tjera që po ju montohen qytetarëve shqiptarë në Maqedoni; çka përmban bashkëpunimi me FSK; a do të bëhet ndonjë marrëveshje për përkrahje që Maqedonia t'i jap Kosovës, për anëtarësim në organizata ndërkombëtare; si do të realizohen pikat e përbashkëta kufitare sipas IBM; a është biseduar se çfarë qëndrimi ka Maqedonia lidhur me mosnjohjen zyrtare të fletë arresteve të Serbisë për pjesëtarë të UÇK-së; a janë kontaktuar dhe a janë informuar partitë e tjera shqiptare për këtë bashkëpunim dhe cilat kanë qenë sugjerimet e tyre; a është biseduar me drejtuesit e komunave shqiptare për të parë se cilat janë nevojat që ata kanë; a jeni koordinuar me MPJ e Shqipërisë rreth temave të shumta; si do të veprohet me lehtësimin e eksportit nga Kosova në Maqedoni.

Enver Hoxhaj, lidhur me OKB-në dhe asociacionin e komunave tha se qëndrimi i tij është se do të duhej një model marrëveshje që asociacioni të integrohet në një pako të madhe të një marrëveshjeje kornizë e cila do të normalizonte raportet Kosovë- Serbi. Shpejtësia e themelimit të asociacionit duhet të shkojë paralelisht me shpejtësinë e anëtarësimit të Kosovës në OKB, tha ai. Sa

i përket dialogut ne duhet të jemi më të vëmendshëm rreth epilogut të dialogut, sesa rreth asaj se kush po shkon në dialog. Konsensusi për dialog duhet të arrihet edhe në tryeza edhe në Kuvend. Z. Hoxhaj njoftoi se çështja e energjetikës dhe e sigurisë drejtohen nga sektorët përkatës ndërsa sa i përket mbështetjes ekziston një gatishmëri nga pala maqedonase për mbështetjen e Kosovës me votën e saj në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Lidhur me IBM theksoi se anëtarë të plotë të saj bëhemi kur anëtarësohemi në BE, ndërsa tani kemi IBM në disa pika. Lidhur me çështjen e ngritur për fletë arreste tha se ato janë biseduar disa herë dhe me këtë çështje është marrë ambasada jonë, si dhe MPJ me shërbimet kompetente. Z. Hoxhaj njoftoi se sa i përket bashkëpunimit të komunave janë duke punuar në këtë drejtim dhe se presin nga prodhuesit e Kosovës sugjerime se çka do të mund të eksportohej nga Kosova në Maqedoni.

Time Kadrijaj krijimi raporteve të mira fqinjësore tha se është kusht për integritet evropian. Përkrahu nismën për arritjen e marrëveshjeve me Maqedoninë ngase një nismë e tillë është dobishme dhe do të funksionoj, ashtu siç është duke funksionuar edhe me Shqipërinë. Zbatimi i këtyre marrëveshjeve tha se do të ndikojnë në zhvillimin e ekonomik, lëvizjen e lirë dhe se një bashkëpunim i tillë edhe me vendet e tjera të rajonit dhe të ndikonte pozitivisht në stabilitetin ekonomik.

Evgjeni Thaçi-Dragusha përkrahu nismën për intensifikimin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve, të cilat kanë të bëjnë me lehtësimin e jetës së qytetarëve. Pyeti zëvendëskryeministrin lidhur me marrëveshjen për diasporën, se çka përfshinë ajo.

Elmi Reçica theksoi se Kosova si nga aspekti gjeopolitik dhe ai gjeostrategjik ka nevojë për bashkëpunim me vendet e rajonit. Me njohjen e emrit të Maqedonisë nga Greqia tha se do të pasojnë hapa për anëtarësim të saj në NATO e BE dhe do të forcohet brenda saj, e po ashtu edhe shqiptarët si faktorë vendimmarrës. Maqedonia tha se e ka mbështetë Kosovën në të gjitha angazhimet e saja. Çështje të rëndësishme të cilave duhet t'u kushtojmë rëndësi tani tha se janë arsimit në Maqedoni, kultura dhe trashëgimia kulturore, bashkëpunimi ekonomik, energjetika e diaspora. Diaspora tha se duhet të organizohet si diasporë shqiptare e jo vetëm e Kosovës. Përkrahu hapjen e pikave kufitare, të cilat tha se janë shumë të rëndësishme tani deri në momentin e hyrjes në BE. Z. Reçica theksoi se Maqedonia duhet t'i afrojë mbështetje Kosovës në të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë, si dhe tani për Interpol, sidomos në vendet ku ne nuk kemi qasje.

Dukagjin Gorani, lidhur me marrëveshjet e listuara në raport pyeti se cilat marrëveshje janë të propozuara, cilat janë të njësuara, cilat janë të gatshme për nënshkrim, dhe shtoi se atyre iu mungon konteksti kohor. Gorani, po ashtu kërkoi shpjegim plotësues se çfarë nënkuptojnë marrëveshjet e caktuara si p.sh. nënshkrimi i memorandumit për bashkëpunim për kontrollin e mallrave strategjike ose marrëveshja e bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e nuk dihet për çka do të lidhet kjo marrëveshje. Kërkoi që në takimin e ardhshëm dokumenti i afruar nga zëvendëskryeministri të përmbajë një projeksion të mundshëm kalendarik, se cilat marrëveshje janë në pritje, cilat janë të përfunduara, cilat pritet të përfundohen dhe cila është përmbajtja e tyre e përafërt. Ai më tej shtoi se është me keqardhje se asnjë marrëveshje nuk përqendrohet në përmirësimin e debalansit tregtar dhe ekonomik që Kosova e ka me Maqedoninë.

Enver Hoxhaj, duke iu referuar diskutimit të znj. Kadrijaj tha se do ta ketë parasysh dhe do të merren në konsideratë sugjerimet edhe sa i takon deklaratën së përbashkët që do të nënshkruhet nga dy Qeveritë, meqë integritet evropian dhe bashkëpunimi rajonal janë prioritet i dorës së parë. Sa i përket pyetjes së deputetes Thaçi-Dragusha lidhur me marrëveshjen për diasporën, njoftoi se marrëveshja e cila do të nënshkruhet në fushën e diasporës është e njëjta e cila është në fuqi sa i takon bashkëpunimit Kosovë – Shqipëri. Ai më tej shtoi se pajtohet me mendimin e deputetit

Reçica, se ka një diasporë, por ka 3 etnitete politike në Ballkan dhe se duhet të mendohet se çfarë do të behet në mënyrë që diaspora të angazhohet më shumë dhe cili do të jetë roli i qeverive të tri vendeve. Hoxhaj njoftoi se do të mbahet një samit i diasporës në Kosovë ku përtej temave klasike është ngritur edhe çështja e koordinimit në mes të tri shteteve në nxitjen dhe mbështetjen për shqiptarët që jetojnë në diasporë që të angazhohen politikisht. Sa i përket bashkëpunimit në fushën e arsimit, Hoxhaj tha se duhet të shihet se a do të mund të kemi kurrikula të përbashkëta me Maqedoninë ashtu siç kemi me Shqipërinë, dhe se do të ishte mirë që në hapësirën e gjuhës shqipe në arsimin e lartë është të krijohet një agjenci i përbashkët e akreditimit. Sa i përket kulturës njoftoi se ka një kalendar kulturor dhe së prioritet është kultura, trashëgimia dhe mbrojtja e monumenteve. Tek ekonomia tha se pajtohet me atë se çfarë tha z. Gorani, se Kosova nuk ka arritur ta ndjek një politikë të zgjuar në raport me Maqedoninë sa i takon balancit tregtar. Njoftoi se Kosova ka pas më shumë marrëveshje bilaterale dhe shkëmbim tregtar ekonomik me Maqedoninë sesa me Shqipërinë, kurse pas janarit të 2014 është balancuar ky raport. Me tej tha se janë në pritje të sugjerimeve nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës sa i takon asaj se si mund të përmirësohet ky balanc tregtar. Lidhur me pyetjen e deputetes Pacolli, sa i takon rastit të Kumanovës, Hoxhaj njoftoi se i ka ndjekur këto raporte pothuajse për 8 vite dhe se e kanë ngritur këtë çështje dhe çështje tjera në takimet me ministrat e jashtëm dhe me kryeministrin Gruevski. Tek afatizimi i marrëveshjeve njoftoi se të gjitha marrëveshjet që janë të listuara mund të nënshkruhen menjëherë dhe se do ta bartë shqetësimin e deputetëve te ministrat lidhur me afatin e zbatimit të këtyre marrëveshjeve.

Elmi Reçica roli i diasporës tha se është integrimi në jetën e shteteve përkatëse, dhe shprehu mendimin se mënyra më e mirë për t'i integruar shqiptarët dhe për të ndikuar në jetën e vendeve ku jetojnë është organizimi që ai propozoi. Çështjet që kanë të bëjnë me kulturën dhe trashëgiminë kulturore, tha se ka një marrëveshje, por ka shumëçka ku mund të ketë koordinim të përbashkët dhe se duhet të investohet në këtë aspekt. Ai shtoi se me nënshkrimin e marrëveshjes në mes të Greqisë dhe Maqedonisë kanë ra poshtë të gjitha pretendimet për ta shkatërruar atë shtet dhe ne duhet të punojmë aktivisht që ta forcojmë faktorin shqiptar atje dhe shtetin të tillë si Maqedoni.

Vjosa Osmani-Sadriu pyeti zëvendëskryeministrin nëse është i informuar se gjatë muajve të fundit, përkundër faktit që Kosova dhe Serbia kanë disa marrëveshje për lëvizjen e lirë, në kufi me Serbinë është duke u ndalur secili person që është shërbyes civil në Republikën e Kosovës. Këtu tha se nuk është fjala vetëm për politikanët e nivelit të lartë, por edhe për shërbyesit civil, anëtarë të FSK-së dhe zyrtarë policorë të Kosovës. Ajo më tej shtoi se, Qeveria e Serbisë duket se ka një vendim për t'i ndalë rreth 100.000 qytetarë të Kosovës që kanë pozita të caktuara në institucionet e Kosovës. Lidhur me Samitin e Londrës tha se ka kërkuar sqarime në takim me ministrin e Jashtëm sa i përket asaj se a ka kthim mbrapa në qëndrimin nga qeveria e kaluar, që mos të pranojë atë që quhej një “jugosllavi e re” sa i përket tregut të përbashkët. Ajo shtoi se përgjigja e ministrit të Jashtëm është se mund të ketë kthim mbrapa, përkundër faktit që qeveria e kaluar ka refuzuar dhe ka kërkuar që bashkëpunimi të jetë më i ngushtë sepse tregu i përbashkët i pranueshëm është ai i BE-së, dhe pyeti se a mbetet kjo qeveri brenda vendimit që është marrë nga qeveria e kaluar. Osmani-Sadriu po ashtu pyeti se cilat janë pritjet e Kosovës nga Samiti i Londrës. Te mbledhjet e qeverive me Shqipërinë, te mbledhja e ardhshme me Qeverinë e Maqedonisë dhe tek aktivitetet rajonale siç është Procesi i Berlinit, ajo sugjeroi që të ketë edhe një dimension parlamentar të këtyre aktiviteteve.

Fitore Pacolli-Dalipi, lidhur me bilancin tregtar dhe me lehtësimin e eksporteve Kosovë-Maqedoni, pyeti se a është dikush në kontakt me prodhuesit vendor.

Zafir Berisha tha se deklarata e z. Hoxhaj, e dhënë më 28 prill ku janë bërë krahasime në mes të ambicies së natyrshme të Kosovës që të ketë ulëse në OKB dhe rritjes së të drejtave të minoritetit

serb përmes asociacionit duket si një parapërgatitje psikologjike e opinionit për kompromise të reja. Lidhur me platformën e propozuar nga Qeveria, të cilën komisioni e ka trajtuar pyeti se pse është tërhequr dhe a është marrë ndonjë vendim për t'u tërhequr. Berisha më tej shtoi se dyshon se ajo është tërhequr për t'i mundësuar Presidentit të bëjë thirrje për konferencë, për të njoftuar se do të shkojë në Bruksel. Shprehu mendimin se tryeza e partive politike nuk e zëvendëson rolin dhe rëndësinë Kushtetuese dhe ligjore të Kuvendit, sidomos sa i përket bisedimeve finale me Serbinë.

Enver Hoxhaj, sa i përket lëvizjes së lirë njoftoi se pranojnë dhe ballafaqohen çdo ditë me informata se shërbyesit civil të institucioneve të Kosovës janë ndaluar dhe janë kthyer mbrapa pa asnjë arsye, dhe shtoi se ka një listë me emra dhe mbiemra se kush ndalohet. Lidhur me këtë njoftoi se ia ka dërguar letër z. Johannes Hahn dhe z. Thorbjorn Jagland. Ai shprehu mendimin se Komisioni Evropian në raportin për Serbinë do të duhej të marrë shënim prej këtyre rasteve. Lidhur me Luginën e Preshevës, Hoxhaj njoftoi se ekziston një situatë ku institucione të caktuara të Serbisë vizitojnë shtëpitë e shqiptarëve që jetojnë në Luginë të Preshevës për tu informuar se a jetojnë këta në Serbi, apo nuk jetojnë aty dhe shpeshherë bëjnë përpjekje që t'i çregjistrojnë. Kjo tha se është një politikë e menduar mirë e shpopullimit të tri komunave të Luginës së Preshevës dhe se për këtë në vitin e kaluar dhe këtë vit kemi ngritur disa herë shqetësimet tona në Bruksel. Hoxhaj lidhur me idenë e tregut të përbashkët rajonal, njoftoi se është kundërshtuar nga Qeveria në mandatin e kaluar dhe se ky qëndrim nuk ka ndryshuar as në këtë qeveri. Shprehu mendimin se në kuadër të CEFTA-së ka disa mekanizma për bashkëpunim rajonal në fushën e ekonomisë dhe të tregut të përbashkët, dhe se rajoni me nënshkrimin e MSA-së është një lloj zgjatje e tregut evropian. Ideja që të mos ketë pika të përbashkëta doganore dhe përpjekja e Serbisë për një dominim ekonomik në rajon për neve është e papranueshme shtoi Hoxhaj. Pa njohjen e Kosovës nga Serbia dhe nga Bosnja ne jemi kundër tregut të përbashkët rajonal dhe nuk kemi asnjë interes. Te dimensionin parlamentar, tha se do t'ia përcjellë kryeministrit edhe të tjerëve që në mbledhjet e përbashkëta të dy qeverive, të shihet mundësua që Komisioni për Punë të Jashtme dhe ai për Integritet Evropian të kenë ndonjë bashkëpunim apo takim. Ai njoftoi për takimet që do të mbahen në Samitin e Londrës, për temat që do të diskutohen dhe shtoi se do nënshkruhet një deklaratë nga kryeministrit e rajonit e cila ka të bëjë me bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore. Tema kryesore tha se do të jetë nënshkrimi i një deklaratë e cila merret me çështjet e pajtimit dhe me personat e zhdukur. Sa i përket pritjeve që i ka Kosova nga Procesi i Berlinit tha se ndër të tjera autostrada Nish-Prishtinë mund të jetë njëra nga pritjet e këtij takimi. Duke iu referuar pyetjeve të deputetit Berisha, Hoxhaj shprehu mendimin se forma aktuale e asociacionit nuk do të duhej të themelohet faktikisht dhe juridikisht pa anëtarësimin e Kosovës në OKB duke shtuar se marrëveshja e përgjithshme do të duhej ta përcakton pozitën e juridike të Kosovës në OKB. Sa i përket platformës së propozuar nga Qeveria, Hoxhaj tha se nuk e sheh tryezën e partive politike si zëvendësim të Kuvendit, por si mjet drejt arritjes së konsensusit në Kuvend.

Vjosa Osmani-Sadriu, lidhur me platformën e propozuar nga qeverisë, njoftoi se komisioni nuk është pajtuar me tekstin dhe ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që të organizojë debat parlamentar, ku grupet parlamentare do të propozojnë rekomandimet e veta, të cilat do të shërbejnë për ndërtimin e platformës konsensuale. Mungesa e veprimit të Kuvendit tha se po krijon hapësirë për trupa jashtë Kuvendit, mirëpo ato assesi nuk mund ta marrin rolin e Kuvendit.

Time Kadrijaj tha se ditën kur është caktuar seanca për të diskutuar për platformën e qeverisë të gjitha partitë politike janë deklaruar se janë kundër dhe nuk i është dhënë mundësia për debat ku do të plotësohej dhe ndryshohej platforma e propozuar.

Vjosa Osmani-Sadriu tha se kemi dalë kundër platformës, mirëpo rekomandimi i komisionit ka qenë që platforma e re konsensuale dhe nacionale të jetë rezultat i një debati parlamentar. Ajo tha

se është trajtuar vetëm rekomandimi i parë i parë i komisioni që ka pas të bëjë me platformën e propozuar, por jo rekomandimi i dytë i komisionit që ka kërkuar që platforma e re të jetë rezultat i një debati të gjerë, gjithëpërfshirës të Kuvendit të Kosovës.

4. Të ndryshme.

Vjosa Osmani-Sadriu njoftoi për ndryshimet e deputetëve të komisionit, ku në vend të deputetëve Aida Dërguti dhe Visar Ymeri janë emëruar deputetët Glauk Konjufca dhe Fitore Pacolli- Dalipi. Ajo, po ashtu, njoftoi për mbajtjen e një tryezë, e cila do të organizohet më 2 korrik nga Komisioni për Punë të Jashtme në bashkëpunim me disa organizata të shoqërisë civile rreth dialogut, ku do të prezantohet një publikim nga disa ekspertë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.